



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 1798 / Prot.
5.1

Patos, më 17.07 / 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 16 KORRIK 2025

Vendi: Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 10:30

Ora e mbarimit: 11:30

**Dëgjuesë publike me temë: “Plani i mbarështimit të Ekonomisë Pyjore-Ana e Lumit
Seman 2”**

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1675 prot., datë 02.06.2025 së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli , Kryetari i Këshillit të Bashkisë z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Përfqësues nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit, *rreth 36 pjesëmarrës (kryetarë të fshatrave, përfaqësues të banorëve të qytetit të Patosit, përfaqësues të institucioneve publike dhe jopublike, ASHP etj).*

Takimin hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetar i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjuesë publike me temë:
“Plani i mbarështimit të Ekonomisë
Pyjore-Ana e Lumit Seman 2”**

Korrik 2025

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesës me nr. 1675 prot., datë 02.06.2025 të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, Taksave, Mjedisit dhe Turizmit për zhvillimin e dëgjësës publike lidhur me Planin e mbarështimit të Ekonomisë Pyjore-Ana e Lumit Seman 2, sot jemi mbledhur për të marr komentet dhe rekomandimet lidhur me draft planin e hartuar për bashkinë Patos. Ju ftoj të gjithëve të ndiqni prezantimin e përfaqësuesve të bashkisë dhe jemi të hapur për të marr komentet dhe rekomandimet tuaja.

Zv/ Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë z. Donald Xhafa– përshëndetje të gjithëve! Ju falenderoj që jeni bërë pjesë e kësaj dëgjese publike. Unë do të filloj me prezantimin e Planit. Ky është një plan me afat 10 vjeçar. Referenca kryesore është ligji Nr 9385, date 4.05.2005:



**Zv/ Kryetare e bashkisë Patos
Znj. Ina Sauli**

**Dëgjese publike me temë:
“Plani i mbarështimit të Ekonomisë
Pyjore-Ana e Lumit Seman 2”**

Korrik 2025


“Për pyjet dhe Shërbimin Pyjor-i ndryshuar” i cili ka pësuar ndryshime në disa pjesë të tij dhe kjo është reflektuar në Ligjin nr. 9791, date 23.07.2007 dhe së fundmi në Ligjin Nr. 48, datë 05.05.2016. Ligjin nr 57/2020 “ Për pyjet” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij si edhe Ligjit nr. 9693, dt 19.03.2007 “Për fondin kullosor” i ndryshuar. “Plani i mbarështimit” është dokumenti bazë për mbarështimin e pyjeve, i hartuar në nivel ekonomie pyjore dhe përfshin: studimin e përgjithshëm të ekonomisë pyjore në aspektin e përshkrimit, organizimit territorial dhe studimit të kushteve stacionale të prodhimit, punimet e terrenit ose inventarizimi i ekonomisë pyjore duke përdorur si njësi bazë grumbullin pyjor (nënparcelën pyjore), planifikimin e masave dhe punimeve në aspektin afatgjat dhe organizimin e procesit të prodhimit. Qëllimi kryesor i këtij Plani Mbarështimi të Pyjeve dhe Kullotave (PMPK) është të zhvillojë mbarështim të qëndrueshëm dhe shumëfunksional të pyjeve dhe kullotave bashkiake brenda kufijve të Ekonomisë Pyjore (EP) Ana e lumit Seman 2 për periudhën 2025-2034, duke balancuar aspektet ekonomike, sociale dhe ekologjike. Ekonomia pyjore

seman 2 ben pjesë në zonën mesdhetare fushore. Ka një terren të rrafshët, ku pjesët më të larta janë krijuar nga depozitimet aluviale të lumit Seman.

Fshati Belinë bënë pjesë ne zonën mesdhetare fushore qendrore të Shqipërisë që përgjithësisht dallohet për një klimë me karakteristika të theksuara mesdhetare e me dimër relativisht të butë. Temperatura mesatare vjetore lëviz nga 15-16 gradë C ndërkohë që periudha e vegjetacionit (periudha me temperaturë të barabartë ose mbi 10°C) fillon mesatarisht në dekadën e parë të muajit Mars e vazhdon deri në fund të muajit Nëntor.

Numri mesatar i ditëve me rreshje (llogariten ditët me rreshje të barabarta ose me më shumë se 1 mm shi në 24 orë) vrojtohet nga 85-100 ditë në vit. Sasia mesatare vjetore e rreshjeve që bien në këtë zonë është relativisht e pakët. Ajo lëviz nga 930 mm deri në 1200 mm shi në vit, ndërkohë që kjo vlerë ka ndryshim të ndjeshëm edhe sipas periudhave stinore. Fshati Belinë ka 400 ha tokë bujqësore nga të cilat 120 ha janë brenda argjinaturës së lumit Seman. Toka klasifikohet si në ngjyrë gri në kafe, e ndikuar nga aktiviteti i erozionit dhe me përmbajtje mesatare të humusit dhe azotit. Për sa i përket konsideratave mjedisore vlen të përmendim krijimin e një brezi mbrojtës me pyje i cili shkon paralel me lumin seman i cili do të bëj të mundur shmangien e erozionit nga lumi i cili ka potencialin për të qënë katastrofik për gjith zonën fushore në të cilën kalon, rritje të volumit të materialit drusor dhe "sekuestrimit" të karbonit. Duke shtuar sipërfaqet pyjore do të sjell si pasojë edhe një mundësi zhvillimi të zonës. Është prezent erozioni i ujit i cili vjen i pasojë e prurjeve të lumit por dhe lartësisë relativisht të ulët të nivelit të tokës në pjesën veriore të argjinaturës. Në ekonominë pyjore seman 2 vihet re prania e pyjeve natyrale me shelg, rrap, plep, marinë, akacie, e shkurreve si murrizi, kulumbria, por gjithashtu ekziston edhe prnia e pemëve frutore dhe kanë një shpërndarje rreth 60 %. Bimësia barishtore mbulon rreth 40 % të sipërfaqes dhe shtrihet kryesisht në zonat e papyllëzuara, me bimë kryesisht si tershëra e egër, liliumi, terfiloret, si tërfili i bardhë. Në zonën pyjore ka edhe lloje të tjera të bimëve aromatike dhe mjeksore si kina e fushës, menta e egër, thundër mushka, etj. Gjendja shëndetësore dhe fitosanitare e grumbujve pyjorë përgjithësisht vlerësohet të jetë e mirë. Ne grumbujt pyjore të kesaj ekonomie nuk ka shenja të ndikimeve të patogjenëve.

Anëtar i Këshillit Bashkiak, z. Novruz Toska- unë kasha një sugjerim. Pylli i Drenies është një nga masivët më të mëdha. A ka ndonjë plan bashkia lidhur me menaxhimine atij pylli? Ky pyll ka shumë lëndë të nevojshme që mund të mbukojnë nevoja të bashkisë për ngrohjen e kopshteve, çerdheve etj.



**Anëtar i Këshillit Bashkiak
z. Novruz Toska**

Dëgjese publike:

**“Plani i mbarështimit të Ekonomisë
Pyjore-Ana e Lumit Seman 2”**

Korrik 2025

Zv/ Drejtor i Bujqësisë, z. Donald Xhafa- Ky është plani i parë dhe duke qenë se është



**Zv/ Drejtor i Bujqësisë
z. Donald Xhafa**

Dëgjese publike:

**“Plani i mbarështimit të Ekonomisë
Pyjore-Ana e Lumit Seman 2”**

Korrik 2025

ekonomia më e thjeshtë dhe më e aksesueshme synon të fillohet në Belinë në ekonominë pyjore Seman 2 dhe më pas në zona të tjera. Aktualisht nuk ka një plan shfrytëzimi për Drenien.

Kryetar i fshatit Rerës, z. Shaban Ruçaj- Pra disa ditësh ra zjarr në zonën që unë mbuloj. Dua të di a do të merren masa lidhur me ullinjt që u dëmtuan dhe u dogjën?



**Kryetar i fshatit Rerës
z. Shaban Ruçaj**

Dëgjese publike:

**“Plani i mbarështimit të Ekonomisë
Pyjore-Ana e Lumit Seman 2”**

Korrik 2025

Zv/ Drejtor i Bujqësisë, z. Donald Xhafa- Lidhur me këtë problem do të ngrihet një grup punë i cili do të verifikoj gjendjen dhe do të ndërmarr masa.



**Zv/ Drejtor i Bujqësisë
z. Donald Xhafa**

Dëgjese publike:

**“Plani i mbarështimit të Ekonomisë
Pyjore-Ana e Lumit Seman 2”**

Korrik 2025

Përfaqësues i prefekturës, z. Agim Gjondedaj- unë dëgjova që ky është një projekt afatgjatë dhe shumë i rëndësishëm për zonën. Unë shpreh një optimizëm që ky projekt do të sjell benefite shumë të mëdha.



**Përfaqësues i prefekturës
z. Agim Gjondedaj**

Dëgjese publike:

**“Plani i mbarështimit të Ekonomisë
Pyjore-Ana e Lumit Seman 2”**

Korrik 2025

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Të nderuar të ftuar dhe grupe interesi ju



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjese publike:

**“Plani i mbarështimit të Ekonomisë
Pyjore-Ana e Lumit Seman 2”**

Korrik 2025

falenderoj që keni qenë pjesë e kësaj dëgjese. Shihemi në dëgjesat e ardhshme.

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba